REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2019:167685
Datë:	29.10.2021
Numri i dokumentit:	02340164

PA1.nr.1060/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm- në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Zyhdi Haziri dhe Ferit Osmani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ardianë Morina, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. M, nga Prishtina, me vendbanim në lagjen ...., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 275 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur përkitazi sipas ankesës së të akuzuarit M. M, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.425/2019, të datës 07.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.10.2021, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të akuzuarit M. M, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore, në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.425/2019, i datës 07.07.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar P.nr.427/2019, të datës 07.07.2021, të akuzuarin M. M, e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale "Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", nga neni

2021:179864

275 paragrafi 1 i KPRK-së, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me kusht dhe gjobë, ashtu që dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, ndërsa gjykata, dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekutoj në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale. Gjithashtu, gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënim me gjobë në shumë prej 400.oo€ (katërqind euro), e të cilën obligohet ta përmbushë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 46 paragrafi 3, i KPRK-së, mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) euro gjobë. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20.oo€ (njëzetë euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 30.oo€ (tridhjetë euro), e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Po ashtu, është konfiskuar sasia e narkotikeve e llojit marihuanë, me peshë prej 10.7 gram.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar i akuzuari M. M, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, të merr vendim që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshojë, dhe çështjen ta kthej për rigjykim dhe vendim, sa i përket shqiptimit të sanksionit penal- dënimit me gjobë.

Prokurori i Apelit, në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1076/2021, të datës 27.09.2021, ka propozuar që të refuzohet si e bazuar ankesa e të akuzuarit M. M, ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394, të KPPK-së, dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal, në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

2021:179864

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari, e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë, nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Për këtë arsye, aktgjykimi i ankimuar, u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore, lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

I akuzuarit M. M, e ankimon aktgjykimin e atakuar, lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, duke pretenduar që gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, ka shqiptuar dënim shumë të lartë për të sepse i akuzuari në ankesë thekson se duke pasur parasysh gjendjen e tij materiale-ekonomike, duke qenë i papunë, mbajtës i familjes, dhe baba i dy fëmijëve, me familje 4 anëtaresh, dënimi i shqiptuar prej 400.oo Euro, është mjaft i lartë dhe nuk ka mundësi financiare që të njëjtin ta paguajë, andaj nga kolegji penal i Gjykatës Apelit, kërkon që pas shqyrtimit të ankesës sime të merr për bazë gjendjen time ekonomike dhe të bëjë ndryshimin e lartësisë së dënimit prej 400.oo€ (katërqind Euro), të shqiptuara me gjobë, gjegjësisht ta zvogëloj dënimin e shqiptuar me gjobë dhe dënimi i ri i shqiptuar të më mundësohet që ta kryejë me disa këste, pasi që me një këst të vetëm nuk kam mundësi që ta paguajë.

Gjykata e Apelit, në Prishtinë, vlerëson se pretendimet ankimore të të akuzuarit, që ti shqiptohet një dënim më i ulët me gjobë, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë, në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur, nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët me gjobë, ndaj të akuzuarit.

Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjeti pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, keqardhjen që i njëjti e ka shfaqur, po ashtu edhe gjendjen e tij financiare momentale. Gjithashtu me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal gjykata vlerësoi si shumë të rëndësishme faktin se i akuzuari nga koha e kryerjes së veprës penale e që kanë kaluar rreth dy vite e gjysmë, nuk ka pasur probleme me ligjin dhe tani i është kthyer jetës normale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata morri për bazë sasinë e narkotikut të cilën e ka poseduar i njëjti (sasi e përgjithshme 10.7 gram). Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante

2021:179864

për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm, e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet në të cilat thirret prokurori, janë të pa bazuara, si dhe nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, apo që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më të ulët me gjobë , sikurse që pretendohet në ankesë. Të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate, japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38, të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1060/21, më datë 28.10.2021

Bashkëpunëtorja profesionale,	Anëtarët e kolegjit:	Kryetar i kolegjit,
Ardianë Morina	Zyhdi Haziri	Hashim Çollaku
_____	_____	_____
	Ferit Osmani	
	_____	

2021:179864